

V E N D I M
Nr.455, datë 22.7.1998

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7845, DATË 13.7.1994 “PËR NUMRIN E SIGURIMIT
SHOQËROR”**

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ministrisë së Pushtetit Lokal, vendos numrin e sigurimit shoqëror.

2. Numri i sigurimit shoqëror është një numër me dhjetë elemente, me informacion të koduar dhe me këtë strukturë:

Elementi 1-2	viti i lindjes
Elementi 3-4	muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6	data e lindjes
Elementi 7-9	numri i vazhdueshëm brenda së njëjtës datë

Elementi 10 element kontrolli

Instituti i Sigurimeve Shoqërore përcakton mënyrën dhe veprimet që kryen për nxjerrjen e numrit të sigurimit shoqëror.

3. Prefekurat:

a) të ngarkojnë drejtuesit e zyrave të gjendjes civile të bashkëpunojnë me përfaqësuesit e ISSH-së për të marrë informacionin e nevojshëm për nxjerrjen e numrit të sigurimit shoqëror, nëpërmjet regjistrave të zyrave të gjendjeve civile;

b) të caktojnë punonjësit përkatës të zyrave të gjendjes civile për plotësimin e formularëve të regjistrimit të numrit të sigurimit shoqëror;

c) të organizojnë punën në zyrat e gjendjes civile për plotësimin e formularëve, me të dhënat e nevojshme personale, për nxjerrjen e numrit të sigurimit shoqëror.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore:

a) përcakton dhe miraton modelin e formularëve: “Formularë për lindjet” dhe “Formularë për vdekjet”;

b) paguan zyrat e gjendjes civile për plotësimin e formularëve me një tarifë të caktuar për çdo formular të plotësuar, vetëm pasi inspektorët e ISSH-së kanë pranuar dhe miratuar rezultatin e punës së kryer. Tarifa caktohet në fillim të çdo fund viti financiar;

c) përcakton afatet dhe procedurën e mbledhjes së formularëve;

ç) informon personin për numrin e tij të sigurimit shoqëror;

d) përcakton metodën, mjetet dhe vendin e ruajtjes së formularëve: “Formularë për lindjet” dhe “Formularë për vdekjet”;

e) planifikon, prokuron, shtyp dhe shpërndan formularët tip të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi;

f) informon zyrat e gjendjes civile për numrin e sigurimit shoqëror.

5. Drejtoritë rajonale të ISSH-së dhe drejtuesit e zyrave të gjendjes civile lidhin aktmarrëveshje, ku të përcaktohen detyrimi për plotësimin e formularëve, afati i plotësimit, cilësia e punës dhe mënyra e pagesës.

6. Zyrat e gjendjes civile të informojnë rregullisht regjistrin qendror të ISSH-së për lindjet dhe vdekjet, në bazë të formularëve të përcaktuar nga ky institut, duke filluar nga data 1 tetor 1998.

Inspektorët e ISSH-së kanë të drejtë të mbikëqyrin këtë veprimtari e cila do të kryhet nga zyra e gjendjes civile.

7. Agjencitë bankare, ku derdhen kontributet për sigurimet shoqërore, agjencitë paguese të përfitimeve nga sigurimet shoqërore, si dhe punëdhënësit që paguajnë kontribute për punëmarrësit e tyre, detyrohen të përdorin numrin e sigurimit shoqëror për të treguar personin, në favor të të cilit janë derdhur kontributet ose janë paguar përfitimet.

8. Për të lindurit para datës 1 tetor 1998 plotësimi i informacionit të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.199, datë 2.5.1992.

9. Efektet financiare përballohen nga buxheti vjetor i ISSH-së.

10. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Lokal dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano